



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:030895

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396909

C.nr.549/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.Sh. me numër personal F.M. me numër personal A.V. me numër personal U.Sh. me numër personal dhe A.Sh. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqësojnë av.B.K. dhe av.F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 12,971.61 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.Sh. F.M., A.V., U.Sh. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses S.Sh. për periudhën kohore prej datës 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021 apo për 27 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,494.45 euro;
- Paditësit F.M. për periudhën kohore prej datës 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021 apo për 27 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,494.45 euro;
- Paditëses A.V. për periudhën kohore prej datës 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021 apo për 27 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,494.45 euro;
- Paditësit U.Sh. për periudhën kohore prej datës 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021 apo për 27 muaj (për çdo muaj shumën prej 45.09 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,217.43 euro;

- Padi tëses A.Sh. për periudhën kohore prej datës 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021 apo për 27 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,494.45 euro;
-të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 16.02.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 332.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadi së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 12,971.61 euro, përkatësisht në shumën prej 5,499.36 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më datë 16.02.2019 apo për 21 muaj.

A r s y e t i m

Paditësit S.Sh. F.M., A.V., U.Sh. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë av.B.K. dhe av.F.G. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 12,971.61 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë ShFMU "Hysni Temaj" në fshatin Kushnin, komuna e Prizrenit, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se për kualifikimin e paditësve me diplomë të fakultetit 3 apo 4 vjeçar, duhet të bëhet kompensimi shtesë prej 27% të vlerës së pagës bazë, e cila është 421 euro, apo shuma e gradimit 113.67 euro, ku aktualisht i paguhet vetëm shuma prej 58.32 euro, përkatësisht 55.35 euro në muaj më pak, ndërsa paditësës S.Sh. 59.22 euro në muaj më pak. Të njejtë për 4 vite pune nga data 18.04.2017, e deri me datë 18.04.2021, janë bërë 48 muaj, të cilat shumëzohen me shumën prej 55.35 euro del shuma e përgjithshme prej 2,656.80 euro, për secilin paditës, për paditësen S.Sh. shuma prej 2,842.356 euro, ndërsa për paditësen A.Sh. për periudhën 01.02.2018 deri më 18.04.2021, për 39 muaj, gjithësej shumën prej 2158.65 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadi e paditësve, të detyrohet e paditura t'ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 2,656.80 euro për secilin paditës, paditësës S.Sh. shumën prej 2,842.356 euro, ndërsa paditësës A.Sh. shumën prej 2158.65 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i

ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 353 të LMD-së duke deklaruar se paditësi ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditësit. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit S.Sh. F.M., A.V., U.Sh. dhe A.Sh. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ShFMU “Hysni Temaj” në fshatin Kushnin, komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkuar.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit 06/20 të datës 22.01.2020, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja Saranda Shalaj është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1049, e datës 14.07.2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit matematikë-informatikë. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit 04/20 të datës 22.01.2020, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi F.M. është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 734, e datës 25.05.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit 115/17 të datës 25.09.2017, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja A.V. është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të

përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 367, e datës 22.07.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit 165/20 të datës 22.09.2020, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi U.Sh. është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 95, e datës 25.01.2010 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin bachelor i biologjisë-kimisë. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës e datës 01.02.2018, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja A.Sh. është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse dhe ka filluar punën me datë 01.02.2018, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 406, e datës 30.08.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore nuk i është paguar asnjë shumë.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, nga vërtetimet e lëshuar nga shkolla në të cilën paditësit punojnë si dhe nga kontratat e punës për secilin nga ta, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar paditësve shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditëses A.Sh. nuk ia ka paguar asnjë shumë. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 27 muaj nga data 16.02.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 1,494.45 euro, për secilin paditës.

Sa i përket kërkesës së paditëses S.Sh. që kompensimi në emër të kualifikimit të bëhet në lartësi prej 59.22 euro për çdo muaj, gjykata e ka aprovuar pjesërisht përkatësisht në lartësi prej 55.35 euro në muaj, sepse bazuar në listën e pagave gjykata ka vërtetuar se paditëses në emër të kualifikimit apo licencimit për çdo muaj i është paguar shuma prej 58.32 euro, e jo siq ka pretenduar paditësja se i është paguar shuma prej 54.45 euro, andaj nga 27% i pagës bazë prej 421.00 euro, ka mbetur pa u paguar nga e paditura shuma prej 55.35 euro në muaj, andaj edhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket kërkesës së paditëses A.Sh. që të kompensohet në emër të kualifikimit në lartësi prej 55.35 euro në muaj, për shkak se shumën prej 58.35 euro e ka pranuar, gjykata nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës ka vërtetuar se paditëses nuk i është kompensuar asnjë shumë në emër të kualifikimit apo licencimit nga ana e të paditurës, andaj të njëjtës i kanë takuar 113.67 euro për çdo muaj (27% i pagës bazë 421.00 euro), mirëpo pasi që kërkesa e paditëses ishte në lartësi prej 55.35 euro në muaj, gjykata e ka aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 201 të LPK-së. Po ashtu nga kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka filluar marrëdhënien e punës me datë 01.02.2018, mirëpo kërkesa e tillë edhe ashtu është parashkruar nga dat 01.02.2018 deri me datë 16.02.2019.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 16.02.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 16.02.2022, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 e deri më datë 16.02.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar

për 21 muaj apo në shumën prej 5,499.36 euro, ndërsa paditësit kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësi sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.549/22, të datës 29.02.2024

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.